



Në bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës dhe Kërkesës Nr.02/32237 datë: 07.10.2024 të Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektoriat dhe Emergjencë, Komuna e Kamënicës bënë këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë

Titulli i pozitës: Tre (3) Mirëmbajtës të Hapsirave të Gjellbërta të Qytetit

Nr. i ekzekutuesve: (3) ekzekutues

Orar i punës: 40 në javë

Paga bruto mujore: 420 €

Periudha e angazhimit: (120 ditë)

Detyrat Kryesore:

- Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve;
- Grumbullimi i mbeturinave në vende publike në qytet;
- Kositja e barit me kosë dore dhe me makineri përkatëse sipas nevojës;
- Krasitja e drunjëve, murit në mes rrugës dhe trotuarit;
- Prashitja dhe spërkatja e luleve sezonale, trandafilave dhe të tjera;
- Zbrazja e shportave të mbeturinave nëpër rrugët e qytetit;
- Pastrimi i deponive ilegale të krijuar në qytet;
- Ujitja e drunjve dekorativ;
- Mirëmbajtja e përmendoreve dhe varrezave të dëshmorëve; Vendosija e shenjave të komunikacionit varsisht nga kërkesat;
- Transporti i mbeturinave të ngurta në vende të caktuara;
- Punë të tjera me kërkesë të sektorit përkatës të Shërbimeve Publike.

Kualifikimi:

Shkolla e mesme, përvoja e punës e dëshirueshme, patent shoferi kategoria "B" e dëshirueshme.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i komplettoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (kopje) si vijon:

Dëshmi të kualifikimit shkollor

Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka).

Dokumentin e identifikimit,

Patent shoferi kategoria "B"

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamënicës.

Afati i aplikimit është deri me datë: 23.10.2024, të shpallur në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve.

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike lokale".

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kritereve të shpalljes Publike përmes njoftimit në Web faqe Komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, refuzohen.

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. <u>02</u>	Nr. <u>33156</u>
U. <u>02</u>	Br. <u>02</u>
Nr. i faq. <u>1</u>	Data: <u>15/10</u>
Br. str. <u>02</u>	Datum: <u>2024</u>
KAMENICA	

